



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-036
Prishtinë, më 9 korrik 2018, në orën 10:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 KORRIK 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Xhavit Haliti, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufëra Srbica-Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit: Valmir Klaiqi dhe Gazmend Krasniqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga EURS-ja: Blertha Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Në fillim, kryetari propozoi që Kuvendi të mbajë seanca plenare çdo të enjte për miratimin projektligjeve që kanë të bëjnë me çështjen e integriteteve evropiane dhe me liberalizimin e vizave. Diskutimi i plotë i kryetarit është i dhënë në transkript.

Me propozimin e kryetarit, Kryesia vendosi që seanca plenare të mbahet të enjten, më 12 korrik 2018, me fillim në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Votimi në parim i Projektligjit për aktet juridike,*
4. *Votimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë,*
5. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,*
6. *Votimi i raportit vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
7. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,*
8. *Votimi i raportit vjetor të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2017,*
9. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017,*
10. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, 2019-2021,*
11. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës,*
12. *Votimi i Propozim-rezolutës nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo, për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione,*
13. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë,*
14. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-077 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për familjen i Kosovës,*
15. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës,*
16. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-042 për gjak dhe përbërës të gjakut.*

Në ndërkohë, rendi i ditës mund të plotësohet edhe me pika tjera, të cilat i plotësojnë kushtet për shqyrtim në seancë plenare.

Me propozimin e kryetarit të Kuvendit, Kryesia vendosi që t'i propozohet seancës plenare caktimi i kohës së veçantë për votim për pikat e rendit të ditës që shqyrtohen në seancë.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale